

Gjëra që duhen ditur në lidhje me pre-eklampsinë

Pre-eklampsia është shumë më e përhapur se ç' mendohet - në të vërtetë është ndërlikimi më i zakonshëm mes ndërlikimeve serioze të shtatzanisë. Pre-eklampsia mund të marrë trajta të një sëmundjeje të rrezikshme, madje edhe kërcënuese për jetën, edhe pse sot për sot nuk është studiuar aq mirë sa të mund të parandalohet.

Disa të dhëna kyç për pre-eklampsinë

Çfarë është?

Është një sëmundje që shfaqet vetëm gjatë shtatzanisë dhe mund të prekë njëkohësisht nënën dhe fëmijën e palindur. Në më të shumtën e rasteve sëmundja është e lehtë, por ka edhe një formë serioze, që mund të jetë e rrezikshme. Mes ndërlikimeve më serioze, meritojnë të përmenden konvulsionet, të njohura me emrin "eklampsi"; që këtej edhe emri pre-eklampsi.

Kë prek?

Në formën e saj më të zakonshme, pre-eklampsia prek përafërsisht një në 10 gra. Nga gratë shtatzana, më në rrezik janë ato që bëhen nëna për herë të parë; gratë mbi 40 vjeç; gratë me një BMI mbi 35; gratë me një histori familiare të pre-eklampsisë; kur kanë kaluar dhjetë vjet ose më shumë nga shtatzania e mëparshme; gratë që vuajnë nga tensioni i lartë arterial, diabeti ose sëmundje të veshkave; ato që kanë binjakë ose trinjakë ose më shumë dhe ato që kanë vuajtur nga pre-eklampsia më parë.

Çfarë e shkakton?

Një problem në placentë, që e pakëson ushqimin e fëmijës me gjak. Ky problem shfaqet herët gjatë barrës, por nuk shkakton sëmundjen veçse shumë më vonë - zakonisht gjatë pak javëve të fundit.

Cilat janë shenjat?

Tension i lartë arterial, proteina në urinën e nënës dhe, ndonjëherë, rritje e pamjaftueshme e fëmijës - shenja të cilat të gjitha duhet të diktohen gjatë kontrollit të zakonshëm para lindjes.

Si mjekohet?

Gratë me pre-eklampsi duhen mbajtur nën kontroll - zakonisht në spital ose në një klinikë ditore - dhe mund të duhet të marrin barna për të ulur tensionin arterial.

A mund të kurohet?

Pre-eklampsia zhduket vetvetiu, pas lindjes së fëmijës dhe largimit të placentës nga trupi, meqë problemin e shkakton pikërisht placenta. Për këtë arsye, shumë grave me pre-eklampsi u kërkohet ta lindin fëmijën herët.

A do të shfaqet përsëri?

Në disa gra - mesatarisht një në 20 - do të shfaqet përsëri.

A mund të parashikohet herët gjatë barrës?

Ende jo - prandaj ka aq shumë rëndësi që gratë të vizitojnë rregullisht klinikat e kujdesit për shtatzaninë - por është e mundur të identifikohen ato gra që janë më të ekspozuara ndaj rrezikut.

A mund të parandalohet?

Jo mirë - megjithëse disa mjekë mendojnë se doza të vogla aspirine të marra çdo ditë nën mbikqyrjen e mjekut mund të ndihmojnë në disa raste.

Çfarë mund të bëjnë ato gra që e kanë pasur më parë?

Të këshillohen me ekspertë, të kërkojnë kontrolle të shpeshta gjatë shtatzanisë, të paraqiten rregullisht për vizita dhe të njoftojnë maminë ose mjekun për të gjitha shenjat dhe simptomat që vënë re te vetja.

Shenja për t'u pasur parasysh

- Dhimbje koke të forta e të zgjatura
- Turbullim i pamjes, njolla drite ose njolla të tjera në fushëpamje
- Dhimbje të forta poshtë brinjëve, sidomos në anën e djathtë
- Të vjella (por jo të vjellat gjatë muajve të parë të shtatzanisë)

Për këshilla ose të dhëna në lidhje me çdo aspekt të pre-eklampsisë, telefonojini linjës telefonike të ndihmës "Action on Pre-eclampsia" në numrin 0208 427 4217

Action on Pre-eclampsia
84-88 Pinner Road
Harrow
Middlesex
HA1 4HZ

Email: info@apex.org.uk

www.apex.org.uk

Bamirësi e regjistruar No: 1013557
Kompani e regjistruar No: 2736320